

## SHTOJCË

Date 15.10.2021

**Për ndryshimin e kërkesave për kualifikim të publikuara në Njoftimin e Kontratës për procedurën e prokurimit “Procedurë e kufizuar - prokurim në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë” me objekt “Ndërtim i sistemit të transmetimit shumëkanalësh me valë (radio rele digitale)”**

Autoriteti kontraktor, Ministria e Mbrojtjes bazuar në nenin 46 të VKM nr. 1170, datë 24.12.2020 “Për miratimin e rregullave të prokurimit në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë”, me nismën e vet, përpara mbarimit të afatit për dorëzimin e ofertave në procedurën e prokurimit me objekt “Ndërtim i sistemit të transmetimit shumëkanalësh me valë (radio rele digitale)”, (për shkak të një lapsusi), ka vendosur të bëjë ndryshime në dokumentet e tenderit dhe njoftimin e kontratës (në të cilin publikohen kërkesat për kualifikim për fazën e parë) nëpërmjet hartimit të kësaj shtojce.

Në njoftimin e kontratës të publikuar nga Autoriteti Kontraktor bëhen këto ndryshime:

- **Në kërkesën për kapacitetin teknik**, të fazës 1 – “Parakualifikimi dhe përzgjedhja e kandidatëve”, e cila lidhet me kriterin për kualifikim për kontrata të ngjashme për furnizime të mëparshme, aty ku është përmendur fjala “*të klasifikuara*”, kjo fjalë hiqet.
- **Pika 7 e njoftimit të kontratës:**

Afati kohor për dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje (faza e parë):

**Ishte** : 31.10.2021 (dd/mm/vvvv) ora :10:00, **bëhet 08.11.2021** (dd/mm/vvvv) ora :10:00

Çdo kërkesë tjetër në njoftimin e kontratës, që nuk është përmendur në këtë shtojcë mbetet i pandryshuar.